



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
ODA E PËRMBARUESVE PRIVAT TË KOSOVËS
Komora Privatnih Izvršitelja – Chamber of Private Enforcement Agents



Adresa: Rr. Perandori Justinian, 3/2, Prishtinë

Tel: +383(038) 409-999

Email: info@opk-rks.org

Web: <https://www.opk-rks.org>



SHPALLJE PUBLIKE PËR TENDERIM

(THIRRJE PËR OFERTË)

Numri i prokurimit: OPPK -2025-001

Data e publikimit: 04.08.2025

Në mbështetje të Statutit dhe akteve të tjera normative, Oda e Përmbauesve Privat të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm "Autoriteti Kontraktues"), fton të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar që të paraqesin ofertat e tyre për realizimin e projektit si në vijim:

Lënda e Kontratës: Punimi dhe montimi i shenjave identifikuese për zyrat e përmbauesve privat

1. OBJEKTI DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE TË KONTRATËS

Autoriteti Kontraktues kërkon sigurimin e shërbimeve të plota për prodhimin dhe montimin e shenjave identifikuese për rreth **43 deri në 44 zyre përmbareshme** (specifikohet sakt në ditën e nënshkrimit të kontratës) në territorin e Republikës së Kosovës, dhe atë:

Pjesa 1: Punimi dhe montimi i shenjave Identifikuese të dimensioneve 30x30 (Versioni 1)

- **Sasia:** 43 – 44 copë
- **Materiali:** Metalik (p.sh., inoks, alumini i përpunuar ose material tjetër cilësor dhe jetëgjatë, rezistent ndaj kushteve atmosferike).
- **Dimensionet:** 30 cm x 30 cm.
- **Dizajni:** Sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në modelin "**Versioni 1**", i cili është pjesë integrale e Dosjes së Tenderit.
- **Përfshirja:** Prodhimi i plotë, përfshirë ngjyrosjen, gdhendjen apo printimin sipas standardit të kërkuar.

Pjesa 2: Punimi dhe montimi i shenjave Identifikuese të dimensioneve 80x60

- **Sasia:** 43 – 44 copë
- **Materiali:** Të jenë të punuara nga material plastik i fortifikuar, me cilësi të lartë dhe jetëgjatësi të garantuar për përdorim të jashtëm. Materiali duhet të jetë rezistent ndaj rrezeve UV, reshjeve dhe ndryshimeve të temperaturës, për të parandaluar zbehjen e ngjyrave dhe dëmtimin strukturor. Sugjerohen materiale si Paneli Kompozit i Aluminit (Dibond), PVC i presuar (Forex) me trashësi adekuate, ose Akrilik (Pleksiglas). Zgjedhja finale e materialit do të bëhet në konsultim me ofertuesin fitues, por duhet të përmbushë standardet e larta të qëndrueshmërisë dhe pamjes profesionale.
- **Dimensionet:** 60 cm x 80 cm.
- **Dizajni:** Sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në modelin "**Versioni 2**", i cili është pjesë integrale e Dosjes së Tenderit.
- **Përfshirja:** Prodhimi i plotë, përfshirë ngjyrosjen, gdhendjen apo printimin sipas standardit të kërkuar.

Pjesa 3: Punimi dhe montimi i shenjave Identifikuese të dimensioneve 110x80.

- **Sasia:** 1 copë (Zyra Odës në Prishtinë)
- **Materiali:** Metalik (p.sh., inoks, alumini i përpunuar ose material tjetër cilësor dhe jetëgjatë, rezistent ndaj kushteve atmosferike me mundësi ndriqimi).
- **Dimensionet:** 120 cm x 80 cm.
- **Dizajni:** Sipas formës dhe përmbajtjes së përcaktuar në modelin "**Versioni 3**", i cili është pjesë integrale e Dosjes së Tenderit.
- **Përfshirja:** Prodhimi i plotë, përfshirë ngjyrosjen, gdhendjen apo printimin sipas standardit të kërkuar.

Operatori ekonomik fitues është i obliguar të bëjë vendosjen (montimin) profesional të të dyja llojeve të shenjave në secilën prej 43 - 44 lokacioneve të zyrave përmbartimore.

Lista e plotë e adresave të zyrave do t'i dorëzohet kompanisë fituese pas nënshkrimit të kontratës. (Shtojca 1 – Komunat ku duhet të vendosën shenjat identifikuese)

Montimi duhet të bëhet në mënyrë të sigurt dhe estetike, në përputhje me standardet teknike dhe në lokacionin e saktë të përcaktuar nga secila zyrë.

2. KRITERET E PËRSHTATSHMËRISË DHE KUALIFIKIMIT

Operatorët ekonomikë të interesuar duhet të dëshmojnë se i plotësojnë këto kushte themelore:

1. Të jenë të regjistruar si biznes në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK).
2. Të dëshmojnë përvojë të mëparshme në punë të ngjashme (prodhim dhe montim i shenjave, tabelave reklamuese, etj.).
3. Të paraqesin një portfolio të punëve të kryera që demonstrojnë kapacitetin dhe cilësinë e punë.

Në rast të përzgjedhjes si fitues për punimin e shenjave identifikuese, operatori duhet të na siguroj edhe:

- Një vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) se nuk ka borxhe ndaj ATK-së (jo më i vjetër se 90 ditë),
- Një vërtetim nga Oda e Përmbauesve Privat të Kosovës, që dëshmon se operatori ekonomik nuk është në procedurë përbarimore në cilësinë e debitorit, (jo më i vjetër se 90 ditë).

3. TËRHEQJA E DOSJES SË TENDERIT

Të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar mund të kërkojnë Dosjen e plotë të Tenderit duke dërguar një kërkesë formale në adresën elektronike: Email: info@opk-rks.org

Dosja e Tenderit do t'u dërgohet në formë elektronike.

4. DORËZIMI I OFERTAVE

- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data **19 gusht 2025**, në orën **16:00**.
- Ofertat duhet të dorëzohen në një zarf të mbyllur dhe të vulosur në adresën: **Oda e Përmbauesve Privat të Kosovës, Rr. Perandori Justinian, 3/2, Prishtinë, Kosovë**,
- Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shkruhet qartë: **"OFERTË PËR: PUNIMI DHE MONTIMI I SHENJAVE IDENTIFIKUESE PËR ZYRAT E PËRMBARUESVE PRIVAT, Numri i prokurimit: OPPK-2025-001 "MOS E HAPNI PARA DATËS 26 GUSHT 2025"**
- Ofertat e pranuar pas afatit të lartcekur nuk do të pranohen dhe do të kthehen të pahapura.

5. HAPJA E OFERTAVE

- Hapja publike e ofertave do të bëhet më datë **26 Gusht 2025**, në orën **11:00**, në ambientet e Odës së Përmbaruesve Privat, në adresën e lartcekur.
- Përfaqësuesit e autorizuar të operatorëve ekonomikë ofertues janë të ftuar të marrin pjesë.

6. KRITERET E VLERËSIMIT

Kontrata do t'i jepet ofertuesit përgjegjës dhe të kualifikuar që paraqet **ofertën ekonomikisht më të favorshme me çmimin më të ulët**, duke plotësuar të gjitha kërkesat teknike dhe administrative të specifikuara në Dosjen e Tenderit.

7. INFORMATA SHITESË

- Çdo pyetje apo kërkesë për sqarim në lidhje me këtë tender duhet të dërgohet vetëm përmes email-it në adresën: **info@opk-rks.org**, jo më vonë se **15 Gusht 2025**.
- Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën për të anuluar këtë procedurë tenderimi në çdo kohë para nënshkrimit të kontratës, pa asnjë pasojë juridike apo financiare ndaj tij.

Me respekt,



Oda e Përmbaruesve Privat të Kosovës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBARUES PRIVAT
PRIVATNI IZVRSITELJ - PRIVATE ENFORCEMENT AGENT

Versioni 2: 80 (horizontalisht) x 60 (vertikalisht)

PËRMBARUES PRIVAT

PRIVATNI IZVRSITELJ - PRIVATE ENFORCEMENT AGENT

MSC. HASAN HASANI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

ODA E PËRMBARUESVE PRIVAT TË KOSOVËS
KOMORA PRIVATNIH IZVRSITELJA - CHAMBER OF PRIVATE
ENFORCEMENT AGENTS